
 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istog Municipality of Istog
	Nr. 11 nr. 45/20	Dt. 08.05.2020	

Duke u bazuar në *Ligj të Ndërtimit Nr. 04/L-110* neni 3, nënparagrafi 1.17 dhe neni 8 i UA 6/2017 neni 25 mbi procedurën për ndryshimin e emrit të investitorit, Ligji i Planifikimit Hapësinor nr. 04/L-174, *04/L-013 për Kadastër*, Ligjit të Procedurës Administrative nr. 05/L-031, duke vendosur sipas kërkesës me nr. 11-351-10184 të datës 23.03.2020 së sh.p.k. DELTA GROUP Pejë me pronar Vesel Jusaj për ndërtimin e aneksit – Çvendosja e mbulesës dhe zgjërimi i restorantit dhe terasës për objektin investues – **MOTEL-VILLA në Muzhevinë, Komuna e Istogut** bazuar në Planin Zhvillimor Urban “ISTOGU”, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis në Istog, lëshon këtë:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMI MOTEL - VILLA

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	sh.p.k. DELTA GROUP me pronar Vesel Jusaj në Pejë		
Adresa:	rr. “DËSHMORËT E KOMBIT” nr. 146, Muzhevinë		
Telefoni:	[REDACTED]	Emaili:	

Emri i Projektit:	MOTEL-VILLA në Muzhevinë, Komuna e Istogut		
Emri i Projektuesit:	sh.p.k. DELTA GROUP, Pejë		
Adresa:	rr. “DËSHMORËT E KOMBIT” nr. 146, Njësia në Muzhevinë, Komuna e Istogut		
Telefoni:	[REDACTED]	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: rr. “DËSHMORËT E KOMBIT” nr. 146, Muzhevinë		
Zona(t) Kadastrale: Istog	Nr. i parcelave kadastrale: P- 70806020-01314-4	GPS Koordinatat: x=7458037,115 y=4736069,225

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II <input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: MOTEL-VILLA në Muzhevinë, Komuna e Istogut	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore sh.p.k. DELTA GROUP Pejë me pronar Vesel Jusaj, iu njifet e drejta e Lejes ndërtimore për objektin **MOTEL-VILLA në Muzhevinë, Komuna e Istogut**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi sh.p.k. DELTA GROUP Pejë me pronar Vesel Jusaj ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore - **MOTEL-VILLA në Muzhevinë, Komuna e Istogut.**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim neni 3, nënparagrafi 1.17 dhe neni 8 i UA 6/2017 neni 25 mbi procedurën për ndryshimin e emrit të investitorit, Ligjin Nr. 5/L-031 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e **Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Kushtet Ndërtimore (të aplikuara)
- Vendimi për Pëlqim Mjedisor (të aplikuara)
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri (të aplikuara)
- Elaborati Gjeomekanik (të aplikuara)
- Tri kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e II-te(të aplikuara)
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera

Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: situacioni i ngushtë dhe dokumentacioni tjetër përcjellës

I dorëzohet: Investitorit, Drejtorisë për PUM dhe QSHQ për arkivim

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS NË ISTOGUT,

Zyrtar për urbanizem
ark. Rrustem Gashi

Udh. Sek. Urbanist,
ark. Rexhep Blakaj id

